

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: KUVENDI KOMUNAL MALISHEVE  
(Shëno emrin e Autoritetit Kontraktues)

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: 62500-20-4724-5-2-1  
(Shëno numrin e Aktivitetit të Prokurimit)

Sa i përket tenderit për "RIPARIMI I KANALIZIMEVE FEKALE TË DËMTUARA NËPËR FSHATRA TË KOMUNËS SË MALISHEVËS."

(Shëno titullin e kontratës si në Dosjen e Tenderit)

## ANKESË

### 1. Identifikimi i ankuesit\*

N.N.SH ARDI & SINANI ING SHPK  
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Carralluke Malisheve  
(Adresa)

Malisheve 24000  
(Vendi) (Kodi postar)

044 123 583   
(Numri Telefonit) (Numri i Faks-it)

Mentor Hoti  
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)  
nnshardi@hotmail.com  
(Adresa elektronike)

05.10.2020  
(Data e parashtrimit të ankesës)



\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

### 2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës.

- Data e publikimit të njoftimit të kontratës me 27.08.2020
- Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara 31.08.2020
- Afati i fundit për dorëzim me 07.09.2020 ora 14:30:00 (Hapja e ofertave)
- Procesverbali i hapjes 07.09.2020, ora 14:42.
- Data e njoftimit për vendimin e AK dhe Letra Standarde 21.09.2020 ora 15:22
- Kërkesa për qasje në dokumentacion 23.09.2020.
- Njoftimi për pezullim të aktivitetit 28.09.2020 ora: 10: 34
- Vendim i AK për Kërkesën për Rishqyrtim 29.09.2020 ora 11:33

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po	<input type="checkbox"/>				Jo	<input checked="" type="checkbox"/>	
----	--------------------------	--	--	--	----	-------------------------------------	--

Sepse dorezimi është bërë përmes platformes elektronike të e-prokurimit.  
Procesverbalin e hapjes së ofertave e kemi pranuar përmes platformes elektronike.

**5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet**

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:*

Po	<input checked="" type="checkbox"/>				Jo	<input type="checkbox"/>	
----	-------------------------------------	--	--	--	----	--------------------------	--

Reagimi i kompanisë sonë pas vendimit të AK-së për eliminimin tonë ka qenë fillimisht kërkesa për qasje në dokumentacion zyrtar të ofertuesëve e dates 23.09.2020.

Pas pranimit të dokumentave të kërkuara në kërkesën për qasje, edhe pse nuk na është dhënë qasje sipas kërkesës sonë, pas analizimit të dokumentacionit kemi vërejtur se AK - KK Malishevë ka bërë shkelje me vendimin për shpalljen si OE të përgjegjshëm : Flamuri V SHPK & NT Flamuri & Benita Company& Isuf A Krasniqi

**6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Nuk është zbatuar LIGJI Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Neni 7 Barazia në trajtim/Jo diskriminimi

Neni 59 Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tendereve

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës

**\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.**



## 7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Pas marrjes së njoftimit nga AK për vendimin lidhur me aktivitetin në fjalë, brenda afatit ligjor kemi bërë kërkesë për qasje në dokumente. AK- KK Malishevë na ka krijuar qasje por jo complete veq dokumentacionin e OE fitues na kan ofruar kurse dokumentat e kërkuar zyrtarisht me e-mail nuk na i kan ofruar me pretekst që janë në E- prokurimi. Shif email-in e bashkangjitur.

Konzorciumi NNSH ARDI & SINANI ING SHPK është eliminuar padrejtësisht nga ky aktivitet me pretekstin që nuk ka ofruar Kontraten per Inxhinierin e Infrastruktures Rrugore. Kjo kontrate eshte dorezuar siq e kemi edhe deshmine qe eshte dorezuar. Me ligjin e prokurimit Publik nese nuk dorezohet kontrata dhe eshte ne liste Inxhinieri atehere AK kerkon sqarime dhe OE duhet te ofroje nese i ka por AK nuk ka kerkuar asnje sqarim por na ka eliminuar automatikisht dhe shihet qe ka tendence për eliminim te pa drejte. **KONTRATA PER ING E INFRASTRUKTURES RRUGORE ESHTË NE DOSJE TE DOREZUAR NE e- Prokurimi.**

Dhe për piken tjeter që jemi eliminuar sipas AK është për BS OHSAS 18001:2007 e cila sipas AK nuk ka validitet, gjë që është shumë e lehtë për tu verifikuar por AK as që ka marr mundin për të bërë verifikimin. Pra është sistemi online që duhet të verifikohen çdo ISO standard, por ne si kompani kemi edhe dokumentin qe kemi kerkuar nga komania qe jemi certifikuar me ISO dhe na kan derguar email zyrtar qe kjo ISO ka validitet deri 11.03.2021.

Më poshtë gjeni provat.

Nr. 63 Prot

Date: 23/09/2020


Drejtuar: "SINANI - ING" SH.P.K

Bul. i Dëshmorëve, 72 Kati I-rë, Prishtinë, Republika e Kosovës.

**VERTETIM**

Me anë të kësaj shkrese vertetojmë se kompania "SINANI - ING" SH.P.K me Nr e Biznesit: 71272206; Nr unik identifikues 810199093 dhe adrese Prishtinë, Bul. i Dëshmorëve, 72 Kati I-rë, Prishtinë, Republika e Kosovës është certifikuar nga Organizmi Certifikues AQSCERT shpk me NIPT: L31511026K, me adresë Rruga Jusuf Vrloni, Pallati 1, Hyrja 6, Tirane sipas Standardit Nderkombetare BS OHSAS 18001:2007.

Ne tabelen e mëposhtme keni të identifikuar vlefshmerine e certifikates:



Gjithashtu vlefshmerine mund ta kontrolloni ne web tone ne linkun <http://aqscert.org/#online-aqs-form>.

Ne certifikaten qe ju dispononi aktualisht eshte nje gabim teknik lldhur me daten e skadences se kësaj certifikate pasi data e sakte e skadences eshte 11/03/2021.

**Mënyra e kërimit të klientit:**

Kërkimi i subjektit ka dy elemente të detyrueshëm për plotësim; Emrin e subjektit dhe nr e certifikatës.

Vendosni emrin e saktë të subjektit në kuadratin bosh ( emri ), pastaj vendosni numrin e saktë të certifikatës në kuadratin bosh

(AQSC/x/xxxxxx)dhe shtyp "Kërko".

**Nëse kërkimi juaj nuk jep rezultatin e pritur, zyra e certifikimit është në dispozicionin tuaj për të verifikuar menjëherë statusin e vlefshmerisë në çdo certifikatë.**

Arsyetim:

Shkelje kriteret për dhënie të kontratës ku konsorciumi i referuar nga komisioni vlerësues si operator i përgjegjshëm për lidhje të kontratës, në fakt nuk ka plotësuar kërkesat sipas Dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë dhe rrjedhimisht është OE e papërgjegjshme.

Shkelja ka ndodhur në kërkesat e

1. Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 kërkesa 5 ku është kërkuar që OE të ketë:

Stafi:

Kërkesa e DT:

Inxhinier të infrastruktures rrugore Master. ( 3 vite provoje pune pas diplomimit ).

Si deshmi dokumentare është kërkuar

Për inxhinierin e infrastruktures rrugore të sillet diploma e tij kopje e noterizuar , CV-i e tij, referenca, dhe kontrata e punës.

OE i rekomanduar nuk ka arritur të përmbushë këto kriter pasi që për inxhinier të kërkuar nuk ka ofruar diplome të nostrifikuara pasi që është diplomuar në Republikën e Shqipërisë dhe sipas Ligjit diplomat nga shtetet tjera duhet të nostrifikohen në mënyrë që konsiderohen të pranueshme sipas LPP-së.

Prove: Udhezimit administrativ UA 16/2016 që thotë: Kur një person përfundon studimet jashtë Kosovës atëherë sipas UA 16/2016 të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, neni 3.1 thotë se diploma e tij/saj duhet të nostrifikohet pasi nuk mundet të punojë pa diplomë të nostrifikuar.

Dhe interpretimeve nga KRPP dhe vendimeve të OSHP-së.



**Referencat:**

**Kërkesa e DT:**

Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses së paku 3 kontrata të natyrës së ngjashme në tri (3) vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë ( riparim i kanalizimeve dhe punimi i kanalizimeve ).

Si dëshmi dokumentare është kërkuar

1.Lista e kontratave - të natyrës së ngjashme në 3 vitet e shkuara të bashkangjitura me kopjet proceseve, raporteve të pranimeve të njëjtë, ku identifikohet qarte, shuma, nr. i prokurimit, viti, titulli etj) ose proceset e pranimeve nga OE privat, me kusht që pagesat të janë kryer nëpërmes institucioneve.

OE i rekomanduar nuk ka arritur të përmbushë këto kriter pasi që nuk ka ofruar min 3 referenca të riparimeve të kanalizimeve ose kanalizime siq është kërkuar sipas DT.

**Makineritë:**

**Kërkesa e DT:**

Si dëshmi dokumentare është kërkuar:

Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas specifikimit teknik në dosje. - Një kamion kiper me kapacitet mbi 12 tonë min.2 copë. - Një kamion kiper me kapacitet 4-10 tonë min.1 copë. - Një eskavator me kapacitet mbi 18 tonë min. 1 copë. - Një eskavator me kapacitet 4-6 tonë min. 1 copë. - Një eskavator 4x4 me lug para dhe prapa min. 1 copë. - Makineri për shpim - depertim të rrugëve. - Frez hidroalik për grryrjen e gurit që montohet në eskavator.

Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet të jënë me afat të regjistrimit), ndërsa pajisje tjera, OE duhet të dëshmojë me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD etj). Vëmendje! Në rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet të ofroj marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vëlosur nga të dyja palët. Dëshmit për pajisjet duhet të ofrohen të renditura sipas listës dhe gjithashtu dëshmit duhet të jënë të dukshme.

Mungojnë në ofertën e konzorciumit: "Flamuri V SHPK & NT Flamuri & Benita Company & Isuf A Krasniqi:

1. Një kamion kiper me kapacitet 4-10 tonë min.1 copë.
2. Një eskavator me kapacitet 4-6 tonë min. 1 copë.
3. Makineri për shpim - depertim të rrugëve.
4. Frez hidroalik për grryrjen e gurit që montohet në eskavator.